

NJOFTIM PËR VEND VAKANT PËR SPECIALIST-ARKIVIST.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, kërkon të punësojë një punonjës në administratë me detyrë specialist-arkivist.

Pershkrimi i punes:

Kushtet e përgjithshme:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- ç) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- d) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje si dhe të mos jetë nën hetim;
- dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit;
- e) Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare në degë të shkencave shoqërore ose fusha të tjera të ngjashme.

Kushtet e posaçme:

- a) Të ketë aftësi për të krijuar plane pune efektiv në përpunimin e materialeve arkivore.
- b) Të ketë aftësi për të ndërvepruar në mënyrë efektive.
- c) Të ruajë konfidencialitetin e materialeve arkivore.
- d) Të ketë integritet dhe cilësi të larta morale.
- e) Të marrë pjesë në trajnime të vazhdueshme në lidhje me trajtimin e fondeve arkivore.
- f) Të ketë njohuri të mira kompjuterike të tilla si: Microsoft Word, Excel, Poëer Point, etj.
- g) Te kete njohuri te gjuheve te huaja

Kritere të preferuara, por jo të nevojshme:

- a) Njohja e proceseve të përpunimit e ruajtjes së fondeve arkivore.
- b) Njohja e sistemit të drejtësisë penale dhe procedurave gjyqësore.

Pershkrimi i punes:

Pergjegjesite kryesore:

- a) Punonjësi pranon, ruan e përpunon aktet proceduriale e administrative, në përputhje me procedurat e përshkruara në ligjin nr.9154 datë 06.11.2003 "Për arkivat".

Funksionet kryesore:

- a) Merr në dorëzim fashikuj, akte e dokumentacion për arkivim.
- b) Përpunon materialet arkivore, duke inventarizuar sipas procedurave standart të gjitha këto akte, sin ë formë elektronike, ashtu edhe manuale.
- c) Kujdeset për mirëmbajtjen e indekseve dhe regjistrave të arkivës.
- d) Përgatit mbi kërkesën e të interesuarve, aktet të cilat do të vendosen këtyre personave në dispozicion pas kontaktimit me drejtuesin e prokurorisë dhe prokurorin për marrëdhëniet me publikun.
- ç) Është pjesë e Komisionit të Ekspertizës për përpunimin e materialeve arkivore.
- e) Merr pjesë në trajnimet ku trajtohen çështje që lidhen me arkivat.
- dh) Bashkërendon me Arkivin Shetëror të Sistemit të Drejtësië për problematika të vërejtura në veprimtarinë e përditshme.

Personat e interesuar duhet të paraqesin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, deri në datën e përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhëri, këto dokumenta:

- a) Kërkesë për punësim,
- b) Fotokopje e letërnjoftimit/kartës së identitetit/pasaportë.
- c) CV (Jetëshkrim) të detajuar së bashku me një foto.
- d) Diplomë e shkollës së lartë, dhe master, çertifikatë notash dhe çdo diplomë tjetër që tregon specializimin në fushën e caktuar.
- e) Dëshmi penaliteti.
- f) Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria që nuk ndiqet penalisht .
- g) Fotokopje te librezës së punës ose vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore që të provojë punësimin e mëparshëm ose vërtetim nga qendra e mëparshme e punës, ku të evidentohet pozicioni i punës dhe kohëzgjatja.
- h) Vërtetim vendbanimi.
- i) Vërtetim mjekësor për gjëndjen shëndetësore.

Pranimi i dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët do të bëhet në Kryesekretarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, **deri në datën 23.05.2023 ora 16.00 duke konfirmuar marrjen në dorëzim sipas inventarit të akteve të dorëzuara.**

Verifikimi paraprak i kandidatëve do të bëhet nga Kryesekretari i kësaj Prokurorie, i cili pasi të marrë praktikat dokumentare për secilin kandidat duhet të verifikojë nëse kandidatët kanë plotësuar kushtet e përgjithshme dhe veçanta.

Vlerësimi i kandidatëve nga Komisioni i Pranimi do të bëhet bazuar në dokumentacionin e secilit kandidat si dhe rezultatit të intervistës me secilin prej tyre. Intervista me secilin kandidat, do të kryhet në ambjentet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, **në datë 24.05.2023, nga ora 12.00 deri në orën 14.00.** Njoftimi i datës së intervistimit për kandidatët e kualifikuar do të bëhet me telefon ose email nga Kryesekretaria.

Per çdo sqarim mund të kontaktoni në numrin 0696752740, ose vizitoni faqen e internetit [ëëë.pp.gov.al](http://eëë.pp.gov.al).

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër.

